



Trans Adriatic Pipeline AG

Degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri

Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Pasqyrat Financiare

në dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018





Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur.....	i
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	1
Pasqyra e fitimit dhe humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e fluksit të parave.....	3
1. Informacion i përgjithshëm.....	4
2. Politikat thelbësore kontabël.....	4
3. Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara.....	12
4. Interpretime të Reja Kontabël.....	13
5. Vlerësimet dhe gjykimet kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël.....	14
6. Menaxhimi i riskut financiar.....	15
7. Aktive Afatgjata Materiale.....	18
8. TVSH e arkëtueshme.....	19
9. Aktive të tjera.....	19
10. Mjete Monedare dhe Ekuivalentët e Mjeteve Monedare.....	19
11. Tufim Fitimi.....	20
12. Të pagueshme tregtare dhe të tjera.....	21
13. Provigjionet.....	22
14. Detyrime të tjera.....	22
15. Të ardhurat e atribuara.....	23
16. Shpenzimet e personelit.....	24
17. Shpenzimet administrative.....	24
18. Fitimi nga Këmbimet Valutore, Neto.....	25
19. Angazhimet dhe aktive/detyrime të kushtëzuara.....	25
20. Transaksionet dhe balancat e llogarive me palët e lidhura.....	26
21. Ngjarjet pas periudhës së raportimit.....	27
22. Politikat kontabël para 1 janarit 2018.....	27



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri.

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri ("Shoqëria") më 31 Dhjetor 2018, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2018;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënime shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare në raportin tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e menaxhimit dhe të atyre që janë përgjegjës për qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar", dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur Drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.



Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedurën auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Risku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmujave kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijmësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiaie në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiaie, jemi të detyruar që të tërhoqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimeve shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijmësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimeve shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë përgjegjës për qeverisjen në lidhje me, ndër të tjera, qëllimin e planifikuar dhe afatin e auditimit dhe konstatimet e rëndësishme të auditimit, përfshirë mangësi të konsiderueshme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë kryerjes së auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k

15 Maj 2020

Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjer

Jonid Lamllari



Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e Shoqërisë së Huaj në Shqipëri
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
 (Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç nëse përkohet ndryshe)



	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktivitet			
Aktive afatgjata materiale	7	129,217,871	102,836,038
Totali i Aktiveve Afatgjata		129,217,871	102,836,038
TVSH e arkëtueshme	8	15,641,896	11,485,287
Aktive të tjera	9	607,181	5,574,678
Mjete Monetare dhe Ekuivalente të Mjeteve Monetare	10	86,007	451,015
Totali Aktive Afatshkurtra		16,335,084	17,510,980
Totali i Aktiveve		145,552,955	120,347,018
Detyrimet			
Detyrimi tatimor i shtyrë		74	81
Totali i Detyrimeve Afatgjata		74	81
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	12	4,042,232	15,516,505
Provizionet	13	2,841,450	4,946,122
Detyrime të tjera	14	1,578,644	681,824
Detyrimi për tatim fitimit	11	84,118	3,035
Totali Detyrime Afatshkurtra		8,546,444	21,147,486
Totali i Detyrimeve		8,546,444	21,147,567
Balanca e mbetur neto që i atribuohet Zyrës Qëndrore	20	137,006,437	99,199,451

Pasqyrat financiare të Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e Shoqërisë së Huaj në Shqipëri për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 janë miratuar dhe nënshkruar nga Përfaqësuesi Ligjor më 14 maj 2020.

Malfor Nuri (Vula e Trans Adriatic Pipeline AG-Shqipëri)
 Përfaqësues Ligjor / Menaxher i Vendit

Shënimet nga faqja 4 në 30 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.



Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e Shoqërisë së Huaj në Shqipëri
Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
 (Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç nëse përsëritet ndryshe)



	Shënime	Vit i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Vit i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhurat e atribuara	15	195,002	183,790
Shpenzimet e personelit	16	(77,260)	(92,854)
Shpenzime administrative	17	(89,832)	(75,168)
Shpenzime amortizimi	7	(7,017)	(7,267)
Fitimi nga këmbimi valutor, neto	18	1,043,477	150,091
Të ardhurat / (shpenzime) financiare, neto		561	742
Fitimi para tatimit për vitin dhe rivlerësimi i balancës/gjendjes neto që i atribuohet Zyres Qëndrore		1,064,931	159,334
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	11	(108,192)	(17,896)
Rritja në balancën/gjendjen e mbetur neto që i atribuohet Zyres Qëndrore për vitin nga veprimtaria operacionale		956,739	141,438
		Vit i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Vit i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse			
Rritja në balancën/gjendjen e mbetur neto që i atribuohet Zyres Qëndrore për vitin nga veprimtaria operacionale		956,739	141,438
Rivlerësimi i balancës/gjendjes së mbetur neto që i atribuohet Zyres Qëndrore		(987,937)	(142,679)
Fitimi për vitin			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		31,198	1,241
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		-	-

Shënimet nga faqja 4 në 30 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e Shoqërisë së Huaj në Shqipëri
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
 (Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç nëse përcaktohet ndryshe)



	Shënime	Vit i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Vit i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fluksi monetar nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit dhe rivlerësimi i balancës të mbetur neto atribuuar Zyrës Qendrore		1,064,931	159,334
Rregullimet për:			
Shponzime amortizimi	7	7,017	7,267
Fluksi monetar para ndryshimeve në kapitalin punues		1,071,948	166,601
Rritja e TVSH-së së arkëtueshme		(5,147,739)	(4,212,877)
Rënie / (ritje) e aktiveve të tjera		4,721,864	3,925,518
Rënie në të Arkëtueshme nga Zyra Qendrore		194,942	171,298
(Rënia) / Rritja e të pagueshmeve tregtare		(10,711,297)	1,271,436
Rritje e të pagueshmeve ndaj Zyrës Qendrore		45,280,027	39,916,497
(Rënia) Rritja e provigjoneve		(1,809,118)	4,946,122
Rritja e detyrimeve të tjera		977,569	582,068
Mjete monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		34,578,196	46,766,663
Tatim fitimi i paguar		(24,151)	(26,631)
Mjete monetare neto nga / (të përdorura në) aktivitetet operative		34,554,047	46,740,033
Fluksi monetar nga aktivitetet investuese			
Blerja e Aktiveve Afatgjata	7	(37,187,167)	(48,067,806)
Paratë neto të përdorura në aktivitetet investuese		(37,187,167)	(48,067,806)
Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare		(2,633,122)	(1,327,774)
Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare në fillim të vitit	10	451,015	410,911
Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në balancën e mjeteve monetare në valutë të huaj		2,268,114	1,367,878
Mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare në fund të vitit	10	86,007	451,015

Shënimet nga faqja 4 në 30 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacione të përgjithshme

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") për vitin e mbylltur me 31 Dhjetor 2018 për Gazsjellësin Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e Shoqërisë së Huaj në Shqipëri ("Shoqëria").

Shoqëria është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 2 dhjetor 2009, nën numrin e identifikimit tatimor K924020230.

Zyra Qendrore, Trans Adriatic Pipeline AG, është themeluar në Zvicër, dhe është e angazhuar në planifikimin, zhvillimin, financimin, ndërtimin dhe funksionimin e një gazsjellësi dhe infrastrukturës të lidhur me të për transportin e gazit natyror nga rajoni i Detit Kaspik në tregun Evropian ("Projekti").

Aksionerët e tij përbëhen nga:

	31.12.2018	31.12.2017
Axpo Solutions AG	5%	5%
SNAM S.p.A.	20%	20%
BP Pipelines TAP Limited	20%	20%
AzTAP GmbH	20%	20%
Fluxys Europe B.V.B.A./SPRL	19%	19%
Enagas Internacional S.L.U.	16%	16%

Aktiviteti kryesor. Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është të planifikojë, zhvillojë dhe ndërtojë tubacionin e gazit natyror TAP. Pasi të jetë funksional, TAP do të sigurojë kapacitetin transportues që u mundëson palëve të interesuara të tregojnë gazin e tyre në tregjet evropiane. Shoqëria është një zgjatim i operacioneve të Zyrës Qendrore dhe nuk kryen ndonjë veprimtari të pavarur.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit. Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rruga Papa Gjon Pali II, Qendra e Biznesit ABA, Tiranë, Shqipëri.

Monedha e paraqitjes. Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë ("Lek") shqiptare. Të gjitha shumat janë të rumbullakosura në mijën më të afërt, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Monedha funksionale e Shoqërisë është EUR e cila përputhet me monedhën funksionale të Zyrës Qendrore.

Shoqëria ka 23 të punësuar më 31 Dhjetor 2018 (2017: 23 të punësuar).

Sipas legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare, Shoqëria dhe Zyra Qendrore në Zvicër kanë të njëjtin personalitet juridik dhe si e tillë Shoqëria nuk posedon kapital.





2. Politikat e rëndësishme kontabël

Baza e përgatitjes. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Politikat kryesore kontabël të zbatuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare jepen më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kritike të kontabilitetit.

Përveç ndryshimeve të politikave kontabël rezultuese nga miratimi i SNRF 9 dhe SNRF 15, efektive nga 1 janari 2018, këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse përcaktohet ndryshe, (referojuni Shënimeve 4 dhe 22). Politikat kryesore të kontabilitetit në lidhje me instrumentet financiare dhe njohjen e të ardhurave të aplikuara deri më 31 dhjetor 2017 paraqiten në Shënimin 22.

Gjithashtu kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjyimit ose kompleksitetit, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, paraqiten në Shënimin 3.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Përkthimi në monedhë të huaj

Monedha funksionale dhe e paraqitjes. Monedha funksionale e Shoqërisë është EUR, e cila është e ndryshme nga monedha e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin Shoqëria kryen veprimtarinë e saj. Përcaktimi se cilat janë kushtet specifike themelore ekonomike, kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Zyra Qendrore vlerëson midis faktorëve të tjerë, vendndodhjen e veprimtarive, burimet e të ardhurave, rreziqet që lidhen me aktivitetet dhe emërtimin e monedhave të operacioneve të subjekteve të ndryshme. Shumica e operacioneve të Shoqërisë janë të matura në EUR dhe gjithashtu, EUR është monedha në të cilën menaxhohen rreziqet dhe ekspozimet e Shoqërisë si edhe matet performanca e biznesit të saj. Më e rëndësishmja, Shoqëria kryen shërbime të operacioneve si zgjatim i Zyrës Qendrore dhe nuk vopron me shkallë të qënësishme autonome. Prandaj, duke qenë se monedha funksionale e Zyrës Qendrore është edhe EUR, edhe monedha funksionale e Shoqërisë është gjithashtu e njëjtë.

Transaksionet dhe balancat. Aktivet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit zyrtar të këmbimit të euros në fundin e periudhës përkatëse të raportimit. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutë që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike në kurset zyrtare të këmbimit valutë të euros njihen në fitim ose humbje si fitime / humbje të tjera, neto. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutë që kanë të bëjnë me huazimet, mjetet monetare dhe ekivalentët e mjeteve monetare paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda zërit 'të ardhura ose kosto nga financimi'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera të këmbimit valutë paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda zërit 'Fitimet / (humbjet) e tjera, neto'. Përkthimi me kursin e fundvitit nuk kryhet për zërat jo monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përfshirë investimet në kapitalin neto, përkthehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo monetarë të matur me vlerën e drejtë në një valutë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes së vlerës së drejtë.

Amy 6



2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdimi)

Në këto pasqyra financiare, rezultatet dhe pozicioni financiar i Shoqërisë perkthehen në monedhën e paraqitjes si më poshtë:

(i) aktivet dhe detyrimet për pasqyrën e pozicionit financiar perkthehen me kursin e mbylljes në fund të periudhës përkatëse të raportimit;

(ii) të ardhurat dhe shpenzimet perkthehen me kursin e këmbimit mesatar (përveç nëse kjo mesatare nuk është një përafrim i arsyeshëm i efektit kumulativ të normave që mbizotërojnë në datat e transaksionit, rast në të cilin të ardhurat dhe shpenzimet konvertohen në datat e transaksioneve);

(iii) të gjitha diferencat që rezultojnë nga këmbimi njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Më poshtë janë disa kurse të këmbimit EURO në LEK për njësi të valutës së huaj në datën e raportimit:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kursi mesatar i këmbimit	127.58	134.15
Kursi i këmbimit në datën e raportimit	123.42	132.95

Aktive afatgjata materiale. Aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto, minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar, kur kërkohet. Aktivet afatgjata materiale përfshijnë aktivet në ndërtim e sipër për përdorim në të ardhmen si aktive afatgjata materiale.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e atij zëri të mund të matet me besueshmëri. Kostot e riparimeve të vogla dhe mirëmbajtjes së përditshme shpenzohen kur ato ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të pjesëve kryesore ose komponentëve të aktiveve afatgjata kapitalizohet dhe pjesa e zëvendësuar tërhiqet. Në fund të çdo periudhe raportimi, Drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata. Nëse ekziston ndonjë indikacion i tillë, Drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si më e larta e vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e heqjes së tij dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme rimorret kur është e përshtatshme nëse rezulton që ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të aktivit ose vlerën e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël dhe njihen në fitim ose humbje për vitin brenda fitimeve / humbjeve të tjera.

Amortizimi. Toka nuk amortizohet. Amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve afatgjata llogaritet duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë koston e tyre në vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Kategoria	Jeta e vlefshme e dobishme (vitet)
Mobilje zyre	10
Pajisje zyre	15
IT Hardware	3-5
Linjat e gazsjellësit dhe pajisje të tjera përkatëse ndihmëse	25
Stacionet e kompresorëve	25
Struktura e seksionit bregdetar të gazsjellësit	25
Toka	n/a



Qiraja / E Drejta për Përdorim, interesat e kapitalizuara dhe kosto të tjera jo direkt të atribuueshme të kapitalizuara



2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Toka dhe aktivet në ndërtim e sipër nuk zhvlerësohen. Përmirësimet e qirasë zhvlerësohen për periudhën më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Metoda e amortizimit rishikohet në çdo datë raportimi. Nuk ka patur asnjë ndryshim në metodat e amortizimit për vitin 2018.

Vlera e mbetur e një aktivi është shuma e vlerësuar që Shoqëria aktualisht do të merret nga nxjerrja jashtë përdorimit/shitja e aktivit minus kostot e vlerësuara, nëse aktivi tashmë ishte vjetëruar dhe në gjendjen e pritur në fund të jetës së tij të dobishme. Vlerat e mbetura të aktiveve dhe jeta e tyre e dobishme rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në fund të çdo periudhe raportimi.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që konsiderohet i tillë në fund të periudhës raportuese. Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në të ardhura ose shpenzime për vitin, përveç nëse njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet, ose të rimburohet nga, autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësime nëse pasqyrat financiare janë të autorizuara para dorëzimit të deklaratave përkatëse tatimore. Tatimet e ndryshme përveçse atyre mbi të ardhurat, regjistrohen si shpenzime operative.

Tatim fitimi i shtyrë sigurohet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për mbartje të humbjeve tatimore dhe diferencave të përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël të tyre për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin e njohjes fillestare, tatimi i shtyrë nuk regjistrohet për diferenca të përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një detyrimi në një transaksion tjetër përveç një kombinimi biznesi, nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon në asnjë llogari dhe as në fitim të tatueshëm. Bilancet tatimore të shtyra maten me tarifatat tatimore të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet e mbartura tatimore regjistrohen vetëm në atë masë sa është e mundshme që diferenca e përkohshme do të përdoret në të ardhmen dhe ekziston një fitim i mjaftueshëm i tatueshëm i ardhshëm, në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

Aktivitet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar aktivitet tatimore aktuale ndaj detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivitet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë mbi fitimin lidhen me tatimin mbi të ardhurat e përcaktuar nga i njëjti autoritet tatimor dhe kanë për qëllim shlyerjen e balancave mbi baza neto.

Pozicionet e pasigurta tatimore. Pozitat e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishqyrtohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet tatimore regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozitat do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose miratuar në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo gjykatë të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla.



2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Detyrimet për penalitete, interesat dhe tatimet tjera nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të nevojshme për të shtuar detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, , regjistrohen brenda tatimit mbi fitimin.

Tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të hershëm midis (a) mbledhjes së të ardhurave nga konsumatorët ose (b) furnizimit të mallrave apo shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja në blerje në përgjithësi mund të rikuperohet duke netuar vlerën e TVSH-së në shitje pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në baza bruto dhe shpaloset veçmas si një aktiv dhe pasiv tatimor. Aty ku është bërë një provigjion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të kërkueshme nga debitori, duke përfshirë TVSH-në.

Parapagimet


Parapagimet njihen me kosto minus provigjionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që vetë klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo Shoqëria ka marrë kontrollin mbi aktivin dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin tek Shoqëria. Pagesat paraprake të tjera shënohen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të pranohen, vlera kontabël e parapagimit shlyhet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në të ardhura dhe shpenzime për vitin.

Instrumentet financiare

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në bazë të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose detyrimin individual dhe numrin e instrumenteve të mbajtura nga njësi ekonomike. Ky është rasti edhe nëse vëllimi normal i tregimit ditor të një tregu nuk është i mjaftueshëm për të përvetësuar sasinë e mbajtur dhe vendosja e urdhrave për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknika të vlerësimit, siç janë modelet e flukseve të skontuara të parasë ose modelet që bazohen në transaksionet e kryera me vlerën e tregut ose marrja në konsideratë e të dhënave financiare të palës së investuar, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuar financiarë për të cilët informacioni për çmimet e tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) niveli një janë matje me çmime të kuotuar (të pa rregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime të njëjta, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika vlerësimi me të gjitha inputet materiale të zbatueshme për aktivin ose detyrimin, qoftë direkt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th.,





2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

që rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) mathete e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen në të dhëna vetëm të vëzhgueshme të tregut (d.m.th., matja kërkon inputet domethënëse të pa kontrollueshme). Transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë vlerësohet se kanë ndodhur në fund të periudhës së raportimit.

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose asgjësimit të një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të kishte ndodhur. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifat dhe komisionet e paguara për agjentët (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë të shitjes), këshilltarët, ndërmjetësit dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë, dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxhit ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose mbajtjet.

Kostoja e amortizuar ("AC") është shuma në të cilën instrumenti financiar njihet në njohjen fillestare minus shlyerjet kryesore, plus interesin e akumuluar, dhe për aktivet financiare minus pagesat për humbjet e pritura të kredisë ("ECL"). Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksioneve të shtyra në njohjen fillestare dhe çdo prim ose zbritje të shumës së maturimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e llogaritura nga interesi dhe shpenzimi i interesit të përlogaritur, përfshirë kuponin e përlogaritur dhe zbritjen e amortizuar ose primin (përfshirë tarifën e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit për periudhën përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë e vazhdueshme periodike e interesit (norma efektive e interesit) mbi vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit pagesat e arkitimeve ose arketimeve të ardhshme (pa përfshirë humbjet e kredisë në të ardhmen) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël bruto të instrumentit financiar.

Norma efektive e interesit zbrit flukset monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm në datën tjetër të rivendosjes së çmimit të interesit, përveç primin ose zbritjes që pasqyrojnë shpërndarjen e kredisë mbi normën e specifikuar në instrument, ose variablat e tjerë që nuk janë rivendosur në normat e tregut. Primet ose zbritjet e tilla amortizohen gjatë gjithë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha tarifën e paguara ose të pranuar ndërmjet palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Për aktivet që janë blerë ose kanë origjinë nga zhvlerësimi i kredisë ("POCI"), nëse ka, në njohjen fillestare, norma efektive e interesit rregullohet për riskun e kredisë, d.m.th. llogaritet bazuar në flukset e pritshme të parave në njohjen fillestare në vend të pagesave kontraktuale.

Instrumentet financiare - njohja fillestare. Instrumentet financiare fillimisht regjistrohen në vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ekziston një ndryshim midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit i cili mund të dëshmohet nga transaksione të tjera të vëzhguara në treg në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e të cilave përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara. Pas njohjes fillestare, një kompensim ECL njihet për aktivet financiare të matura në AC dhe investimet në instrumentet e borxhit të matur në FVOCI (vlerë drejtë të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse), duke rezultuar në një humbje të menjëhershme kontabël.

Aug¹¹



2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarje brenda afatit kohor të vendosur me rregullore ose konventë të tregut (blerjet dhe shitjet në "mënyrë të rregullt") regjistrohen në datën e tregtisë, që është data në të cilën Shoqëria merr përsipër të dorëzojë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur njësia ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja pasuese - kategoritë e matjes. Shoqëria klasifikon aktivet financiare në kategorinë e matjes së AC. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të bordit varet nga: (i) modeli i biznesit të Shoqërisë për administrimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të parave të aktivit.

Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja pasuese - modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Shoqëria administron aktivet me qëllim të gjenerimit të flukseve monetare – qoftë nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm për të mbledhur fluksat kontraktuale të parave nga aktivet ("mbajtur për arkëtim e flukseve monetare kontraktuale") ose (ii) për të arkëtuar si fluksat monetare kontraktuale dhe fluksat monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("mbajtur për arkëtim e flukseve monetare kontraktuale dhe shitje") ose, nëse asnjë prej (i) dhe (ii) është i zbatueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e një modeli "tjetër" biznesi dhe maten në FVTPL.

Modeli i biznesit përcaktohet për një grup të aktiveve (në një nivel portofoli) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse në lidhje me aktivitetet që ndërmarrja merr përsipër të arrijë objektivin e përcaktuar për portofolin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët e konsideruar nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë qëllimin dhe përbërjen e një portofoli, përvojën e kaluar se si janë mbledhur fluksat e parave për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen drejtuesit. Referojani Shënimit 5 për gjykime kritike të përdorura nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja e mëposhme - Karakteristikat e fluksit të parave. Kur modeli i biznesit do të mbajë aktive për arkëtim të flukseve monetare kontraktuale ose për të mbajtur fluksat monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse fluksat e parave përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit ("SPPI"). Aktivet financiare me derivate konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktojnë nëse fluksat e tyre të parave janë në përputhje me tiparin SPPI. Në bërjen e këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse fluksat monetare kontraktuale janë në përputhje me një aranzhim bazë të huazimit, d.m.th. interesi përfshin vetëm konsiderimin e riskut të kredisë, vlerën kohore të parave, rreziqet e tjera themelore të huazimit dhe marzhiin e fitimit.

Kur termat kontraktuale prezantojnë ekspozimin ndaj riskut ose paqëndrueshmërinë që është në kundërshtim me një aranzhim bazë kredie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në FVTPL. Vlerësimi i SPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe ai nuk rivlerësohet më pas.

Aktivet financiare - riklasifikimi. Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur ndryshon modeli i biznesit për administrimin e portofolit në tërësi. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe bëhet nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që pason pas ndryshimit në modelin e biznesit. Njësia ekonomike nuk e ndryshoi modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe krahasuese dhe nuk bëri ndonjë riklasifikim.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare – pagesë e humbjes së kredisë për ECL. Shoqëria vlerëson, mbi një bazë të ardhshme, ECL për instrumentet e borxhit të matur në AC dhe FVOCI dhe për ekspozimet që rrjedhin nga angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, për aktivet e kontratës.



2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Shoqëria mat ECL dhe një humbjet neto nga zhvlerësimi në aktivet financiare dhe aktivet e kontratës në secilën datë raportimi. Matja e ECL pasqyron: (i) një shumë objektive dhe me pesë probabiliteti të mundshme që përcaktohet duke vlerësuar një gamë të rezultateve të mundshme, (ii) vlerën kohore të parave dhe (iii) të gjitha informacionet e arsyeshme dhe të mbështetshme që janë të disponueshme pa kosto dhe përpjekje të shtesë në fund të çdo periudhe raportimi për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë është i kufizuar në një numër të limituar palësh kontraktuale dhe si i tillë ECL vlerësohet mbi baza individuale.

Aktivët financiarë – zhvlerësimi. Aktivët financiarë zhvlerësohen, tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka ezauruar të gjitha përpjekjet praktike të rikuperimit dhe ka konkluduar se nuk ka ndonjë pritshmëri të arsyeshme të rikuperimit. Zhvlerësimi paraqet një ngjarje çregjistrimi. Shoqëria mund të shlyejë aktivet financiare që janë ende objekt i veprimtarisë përmbarimore kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë me kontratë, megjithatë, nuk ka ndonjë pritshmëri të arsyeshme të rikuperimit.

Aktivët financiarë – çregjistrimi. Shoqëria fshin nga kontabiliteti aktivet financiare kur (a) aktivet shiten ose të drejtat e fluksit të parave nga aktivet skadojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat në fluksit e parave nga aktivet financiare ose ka lidhur një marrëveshje transferimi kualifikues duke (i) transferuar gjithashtu thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfatimet që rrjedhin nga pronësiambi aktivet ose (ii) mos transferuar dhe as mbartur rreziqet dhe përfatimet që rrjedhin nga pronësi mbi aktivet por duke mos mbajtur kontrollin. Kontrolli ruhet nëse pala tjetër nuk ka mundësi praktike për të shitur aktivin në tërësinë e tij tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë në shitje.

Detyrimet financiare - kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me koston e amortizuar.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare nuk njihen kur shuhet (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen, dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat e njohura, dhe ka një qëllim që ose të shlyhet në bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe shlyejë detyrimin njëkohësisht. Një e drejtë e tillë e kompensimit (a) nuk duhet të varet nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e zbatueshme me ligj në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) gjatë rrjedhës normale të biznesit, (ii) në rast të mospërbushjes së detyrimeve dhe (iii) në rast paafësie paguese ose falimentimi.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në banka, dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.



2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në banka, dhe investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare mbahen me kosto të amortizuar (AC) sepse: (i) ato mbahen për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI, dhe (ii) ato nuk janë të përcaktuara në FVTPL.

Përfitimet e punonjësve

Kontributet shoqërore dhe shëndetësore

Shoqërisë i kërkohet nga legjislacioni aktual shqiptar të japë kontribut fikse në emër të të punësuarve në një fond social të operuar nga Shteti. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën me të cilën ato lidhen.

Provizionet

Provizionet për detyrime dhe tarifa janë detyrime jo-financiare të një kohe dhe shumë të pasigurt. Ato vlerësohen kur Shoqëria ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara, ka të ngjarë që do të kërkohet një rrjedhje burimesh që mishërojnë përfitimë ekonomike për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit mund të bëhet. Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim i interesit.

Njohja e të ardhurave

Bazuar në Marrëveshjen Shumëpalëshe të Cmimit në Avancë midis autoriteteve kompetente të Shqipërisë, Greqisë, Italisë dhe Zvicrës, të ardhurat që Trans Adriatic Pipeline AG do të alokojë tek selitë e saj të përhershme (Degët) do llogariten e kryhensi më poshtë:

Gjatë fazës së zhvillimit, të ardhurat përbëhen nga e ardhura e alokuar nga Zyra Qendrore për të mbuluar shpenzimet lokale operacionale të Shoqërisë, ndërsa gjatë fazës së operimit tregtar të gazsjellesit, të ardhurat e Shoqërisë do të përbëhen nga e ardhura e alokuar nga Zyra Qendrore për të mbuluar shpenzimet lokale operacionale dhe aktivet e kapitalizuara të Shoqërisë.

Të ardhurat paraqiten pa tatimin mbi vlerën e shtuar, rimbursimet, uljet dhe zbritjet dhe pasi shijet brenda Shoqërisë kompensohen, nëse ka. Të ardhurat njihen me kalimin e kohës ndërsa ndodhin shpenzimet operacionale. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ekziston një pasiguri e rëndësishme në lidhje me mbledhjen e shumës së arkëtueshme apo rikuperimin e koston përkatëse.

2. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

Balanca e mbetur neto që i atribuohet Zyrës Qendrore.

Shoqëria nuk është një person juridik i veçantë dhe për rrjedhojë nuk ka emetuar instrumente të kapitalit të vet. Zyra Qendrore ka të drejtë të kërkojë kthimin e investimit të saj tek Dega në para të gatshme. Ky detyrim për shlyerje gjeneron një detyrim të Shoqërisë për vlerën aktuale të shumës së investimit të Zyrës Qendrore. Është jopraktike të përcaktohet shuma e saktë e këtij detyrimi pasi nuk dihet kur dhe nëse Zyra Qendrore do ta kërkojë kthimin e investimit të saj tek Dega.

Në terma praktikë, Dega e mat dhe e njeh "balancën e mbetur neto që i atribuohet Zyrës Qendrore" si vlerën kontabël, të njohur sipas SNRF, të aktiveve neto të Degës. Fitimet e atribuara Shoqërisë që riatdheshohen tek Zyra Qendrore paraqiten si kosto financiare dhe njihen kur paguhen.

3. Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara

Miratimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare". Shoqëria po zbaton SNRF 9, Instrumentet Financiare, që prej 1 Janarit 2018. Shoqëria zgjodhi të mos riparaqesë balancat e periudhës krahasuese, por të njohë çdo rregullim të vlerave kontabël të aktiveve financiare dhe detyrimeve në llogarinet e fitimeve të mbartura në celje që nga data e aplikimit fillestar të standardeve, më 1 janar 2018. Bazuar në analizën e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë, drejtimi i Shoqërisë nuk ka identifikuar ndonjë ndikim domethënës në pasqyrat e saj financiare nga miratimi i standardit të ri në 1 Janar 2018.

Si rrjedhim, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentet Financiare: Shpalesjet, janë aplikuar vetëm për periudhën aktuale. Shpalesjet e periudhës krahasuese përsërisin ato deklarime të bëra në një vit më parë.

Politikat e reja të rëndësishme kontabël të përdorura në periudhën aktuale janë përshkruar në Shënimin 2. Politikat kontabël të aplikuar para 1 janarit 2018 dhe të zbatueshme për informacionin krahasues janë shpalosur në Shënimin 29.

Nuk ka patur asnjë ndikim në balancat e hapjes së Shoqërisë si rezultat i zbatimit të standardit të ri.

Miratimi i SNRF 15 "Të ardhura nga kontratat me klientët". Shoqëria aplikoi metodën e thjeshtuar të kalimit në SNRF 15 dhe zgjodhi të zbatojë mjetin praktik të disponueshëm për metodën e thjeshtuar të kalimit. Shoqëria zbaton SNRF 15 në mënyrë retrospektive vetëm për kontratat që nuk ishin përfunduar në datën e aplikimit fillestar (1 Janar 2018).

Miratimi i SNRF 15 nuk ka rezultuar në ndryshime të rëndësishme në politikat kontabël dhe nuk ka rezultuar në rregullime në pasqyrat financiare.

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive për Shoqërinë që nga 1 janari 2018, por nuk patën ndonjë ndikim material në këtë të fundit:

• Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa në bazë të aksioneve" (publikuar më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).





3. Miratimi i Standardeve dhe Interpretimeve të Reja ose të Rishikuara (vazhdim)

- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimit" (publikuar më 12 Shtator 2016 dhe efektive, në varësi të metodës, për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë një opsion përjashtimi të përkohshëm, ose kur njësisia ekonomike aplikon për herë të parë SNRF 9 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë metodën e mbivendosjes).
- Pëmirësimet Vjetore të Ciklit të SNRF-ve 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 a SNK 28 (publikuar më 8 Dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).
- KIRFN 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe vlera monetare të marra në avandë" (publikuar më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).
- Ndryshimet në SNK 40 - "Transferimet e Aktiveve të mbajtura për Investim" (publikuar më 8 Dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2018).

4. Interpretime të reja kontabël

Janë lëshuar disa standarde dhe interpretime të reja, të cilat janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2019 ose më vonë, dhe të cilat Shoqëria nuk i ka adoptuar herët.

SNRF16, Qiratë (publikuar më 13 Janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019). Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe raportimin e qirave. Të gjitha qiratë rezultojnë në atë që qiramarrësi të fitojë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillimin e qirasë dhe, nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, duke marrë gjithashtu financim. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe, në vend të kësaj, prezanton një model të vetëm të kontabilizimit të qirasë për qiramarrësin. Qiramarrësve t'u kërkohet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha aktivet e marra me qira me një afat më shumë se 12 muaj, përveç nëse aktivi themelor ka vlerë të ulët; dhe (b) amortizimi i të drejtës së përdorimit të aktivit të qirasë i njohur veçmas nga interesi i detyrimeve qirasë në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. SNRF 16 mbart në mënyrë të konsiderueshme kërkesat kontabël të qiradhënësit në SNK 17. Prandaj, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira operative ose qira financiare, dhe i llogarit këto dy lloje të qirave në mënyrë të ndryshme.

Shoqëria vendosi që do të zbatojë standardin nga data e tij e detyrueshme e zbatimit 1 janari 2019 duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive pa rideklarimin e balancave të periudhës krahasuese. E drejta e përdorimit të aktivit të marrë me qira gjatë periudhës kalimtare matet sikur rregullat e reja të ishin zbatuar gjithmonë. Të gjitha aktivet e tjera të së drejtës së përdorimit të aktiveve maten me shumën e detyrimit të qirasë në momentin e zbatimit (rregulluar për çdo shpenzim të parapaguar ose të përlogaritur). Me 31 Dhjetor 2018 Shoqëria ka angazhime afatshkurtra të qirasë, jo të anulueshme, prej 540 mijë Lekë. Shoqëria është në proces të përcaktimit të ndikimit të standardit të ri në datën e aplikimit për herë të parë, 1 Janar 2019.



• 4. Interpretime të reja kontabël (vazhdim)

- Shitja ose Kontributi i Aktiveve në mes të një Investitori dhe shoqërisë së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).

- KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin për Tërimin mbi Fitimin" (publikuar më 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).

- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkëta" (publikuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

- Përmirësime Vjetore të Ciklit të 2015-2017 SNRF-ve - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

- Ndryshimet në SNK 19 "Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes" (publikuar më 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019).

- Ndryshime në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (publikuar më 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

- Përkufizimi i një biznesi - Ndryshime në SNRF 3 (publikuar më 22 Tetor 2018 dhe efektive për blerjet nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020).

- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021)

Nëse nuk përkrahë ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. Vlerësimet kritike kontabël dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e Drejtimit dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana.

Drejtimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit. Gjykimet me efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim të rëndësishëm në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:





5. Vlerësimet kritike kontabël dhe gjykimet në zbatimin e politikave kontabël

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata.

Vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata është një çështje gjykimi bazuar nga përvoja me e vlerësimin e aktiveve të ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të mishëruara në aktive konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Sidoqoftë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsimi teknik ose tregtar dhe amortizimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në aktive. Drejtimi vlerëson jetën e mbetur të dobishme në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periodhën e parashikuar gjatë së cilës aktivet pritet të fitojnë përfitime për Shoqërinë. Konsiderohen faktorët kryesorë të mëposhtëm: (a) përdorimi i pritshëm i aktiveve; (b) konsumimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacionale dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose tregtar që vjen nga ndryshimet në kushtet e tregut.

Monedha funksionale

Monedha funksionale e Shoqërisë është EUR, e cila është e ndryshme nga monedha e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin operon Shoqëria. Ky përcaktim, i asaj që janë kushtet specifike themelore ekonomike, kërkon gjykim. Në vendosjen e këtij gjykimi, Zyra Qendrore vlerëson midis faktorëve të tjerë, vendndodhjen e veprimtarive, burimet e të ardhurave, rreziqet që lidhen me aktivitetet dhe emërtimin e monedhave të operacioneve të subjekteve të ndryshme. Shumica e operacioneve të Shoqërisë janë të matura në EUR dhe gjithashtu, EUR është monedha në të cilën menaxhohen rreziqet dhe ekspozimet e biznesore të Shoqërisë, dhe matet performanca e saj. Më e rëndësishmja, Shoqëria është një zgjatim i e Zyrës së saj Qendrore dhe ajo nuk funksionon me një shkallë të konsiderueshme të autonomisë. Prandaj, duke qenë se monedha funksionale e Zyrës Qendrore është edhe EUR, monedha funksionale e Shoqërisë është gjithashtu e njëjtë.

6. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria mund të jetë e ekspozuar ndaj risqeve të nëpeshime në përdorimin e instrumenteve financiare:

- Risku i kredisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Drejtimi ka përgjegjësi të përgjithshme për krijimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të riskut të Shoqërisë.

Politikat e administrimit të riskut të Shoqërisë janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet Shoqëria, për të përcaktuar kufijtë dhe kontrollet e duhura të rreziqeve dhe për të monitoruar rreziqet. Politikat e Shoqërisë dhe administrimi i riskut zbatohet nga Zyra Qendrore.

Risku i kredisë

Shoqëria merr ekspozimin ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që njëra palë e një instrumenti financiar të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke mos përmbushur një detyrim.

Në datën e raportimit, ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë përbëhet vetëm nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, duke përjashtuar paratë në dorë (Shënimi 9). Shoqëria nuk kishte ekspozime të tjera ndaj riskut të kredisë në atë datë.





6. Menaxhimi i riskut financiar

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare pasi ato të ndodhin. Qasja e Shoqërisë për administrimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë që të jetë e mundur, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur duhet, si në kushte normale dhe ato nën stres, pa pësuar humbje të papranueshme ose duke riskuar dëme në reputacionin e Shoqërisë.

Shoqëria ka mbështetjen e plotë financiare të Zyrës Qendrore të saj në përmbushjen e detyrimeve të saj afatshkurtra pasi operacionet e saj janë një vazhdim i aktiviteteve parësore të Zyrës Qendrore. Maturimet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare paraqiten më poshtë.

Në 31 Dhjetor 2018	Më pak se 6 muaj	Më shumë se 6 muaj	Më shumë se 1 vit	Totali
Aktivët financiarë				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	86,007	-	-	86,007
	86,007	-	-	86,007
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme tregtare	(4,042,232)	-	-	(4,042,232)
	(4,042,232)	-	-	(4,042,232)
Hendeku i likuiditetit	(3,956,225)	-	-	(3,956,225)
Në 31 Dhjetor 2017	Më pak se 6 muaj	Më shumë se 6 muaj	Më shumë se 1 vit	Totali
Aktivët financiarë				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	451,015	-	-	451,015
	451,015	-	-	
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme tregtare	(15,516,505)	-	-	(15,516,505)
	(15,516,505)	-	-	(15,516,505)
Hendeku i likuiditetit	(15,065,490)	-	-	(15,065,490)

Shoqëria përgatit parashikimet dymbëdhjetë mujore të fluksit të parasë në bazë mujore për të siguruar që ka një pamje të plotë të detyrimeve të ardhshme financiare dhe fonde të mjaftueshme për t'i përmbushur ato. Cdo muaj, zyra qendrore mbledh fonde përmes huave të larta të qeverisura nga dokumentet e financimit të projektit dhe / ose rritjet në kapitalin aksionar të qeverisura nga Marrëveshja e Aksionarëve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si normat e këmbimit të huaj, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit neto do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e zotërimeve të saj të instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërsa optimizon kthimin.





6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i valutës

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të valutës që vjen nga ekspozimi ndaj valutave, në mënyrë të veçantë fakturat në EUR.

Risku i valutës rritet kur transaksionet e ardhshme tregtare ose aktivet dhe detyrimet e njohura vlerësohen në një monedhë që nuk është monedhë funksionale e Shoqërisë.

Në 31 Dhjetor 2018	EUR	LEK	TOTALI
Aktivët Financiare			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-	86,007	86,007
Totali i Aktiveve Financiare	-	86,007	86,007
Detyrimet financiare			
Llogaritë e pagueshme tregtare	(4,042,232)	-	(4,042,232)
Totali i detyrimeve financiare	(4,042,232)	-	(4,042,232)
Pozicioni neto i valutës së huaj	(4,042,232)	86,007	(4,042,232)

Në 31 Dhjetor 2017	EUR	LEK	TOTALI
Aktivët Financiare			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	289,294	161,721	451,015
Totali i Aktiveve Financiare	289,294	161,721	451,015
Detyrimet financiare			
Llogaritë e pagueshme tregtare	(15,512,406)	(4,100)	(15,516,506)
Totali i detyrimeve financiare	(15,512,406)	(4,100)	(15,516,506)
Pozicioni neto i valutës së huaj	(15,223,112)	(157,621)	(15,061,391)

Analiza e ndjeshmërisë së vlerave të huaja

Analiza e ndjeshmërisë më poshtë është përcaktuar bazuar në ekspozimin ndaj monedhës së huaj në datën e raportimit dhe ndryshimin e parashikuar që ndodh në fillim të vitit financiar dhe është mbajtur konstant gjatë gjithë periudhës së raportimit. Më poshtë jepet një vlerësim i efekteve të ndryshimeve në kursin e këmbimit në fitimin neto, duke supozuar se të gjithë variablat e tjerë janë mbajtur konstantë:

	2018	2017
EUR e vlerësuar me 10%	404,223	1,522,311
EUR e zhvlerësuar me 10%	(404,223)	(1,522,311)





6. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit është risku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të instrumenteve financiare do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset monetare operative janë në një masë të madhe të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Risku i fluksit të parave dhe ai i normës së interesit kontrollohen përmes aprovimeve të pagesave, kufijve të autorizimit për pagesa dhe procedurave të monitorimit ditor të fluksit të parave të Shoqërisë dhe lëvizjeve në normat e interesit të tregut.




Trans Atlantic Pipeline AG - Dregë e Shoqërisë së Huarë në Shqipëri

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2018

(Të gjitha shtumat në mijë Lekë, përveç nëse përkthohet ndryshe)

7. Aktivet afatgjata materiale

Kosto Në 1 janar 2017 Shëresa	Perritësimet të ambienteve me qira		Pajisje zyre		Pajisjet dhe infrastruktura e IT-së		Aktive në ndërtim		Totali	
Efektë i përkthimit në monedhën e paraqitjes	(391)	(263)	-	(277)	1,606	(277)	(1,508,734)	(1,509,665)	56,301,608	
Në 31 Dhjetor 2017	22,773	15,332	18,148	102,803,497	37,187,166	37,187,166	102,859,750	102,859,750	56,246,010	
Shëresa	-	-	-	-	-	-	-	-	48,066,221	
Efektë i përkthimit në monedhën e paraqitjes	(1,632)	(1,099)	(1,301)	(10,796,211)	(10,800,243)	(10,800,243)	(10,800,243)	(10,800,243)	48,067,806	
Në 31 Dhjetor 2018	21,141	14,233	16,847	129,194,452	129,194,452	129,194,452	129,246,673	129,246,673	1,509,665	
Amortizimi i akumuluar										
Në 1 janar 2017	(6,151)	(7,372)	(3,269)	-	-	-	-	-	(16,792)	
Amortizimi	(2,527)	(1,547)	(3,193)	(7,267)	(7,267)	(7,267)	(7,267)	(7,267)	347	
Efektë i përkthimit në monedhën e paraqitjes	126	138	83	-	-	-	-	-	(23,712)	
Në 31 Dhjetor 2017	(8,552)	(8,781)	(6,379)	-	-	-	-	-	(7,017)	
Amortizimi	(2,404)	(1,471)	(3,142)	(1,929)	(1,929)	(1,929)	(1,929)	(1,929)	1,929	
Efektë i përkthimit në monedhën e paraqitjes	691	677	560	-	-	-	-	-	(28,802)	
Në 31 Dhjetor 2018	(10,265)	(9,575)	(8,962)	-	-	-	-	-	(28,802)	
Vlera kontabël neto										
Në 1 Janar 2017	17,013	8,223	13,571	56,246,010	56,284,817	56,284,817	56,284,817	56,284,817	102,859,750	
Në 31 Dhjetor 2017	14,221	6,551	11,769	102,803,497	102,859,750	102,859,750	102,859,750	102,859,750	102,859,750	
Në 31 Dhjetor 2018	10,876	4,658	7,885	129,194,452	129,246,673	129,246,673	129,246,673	129,246,673	129,246,673	



7. Aktivët afatgjatë materiale (vazhdim)

Aktivët afatgjatë materiale përbëhen nga përmirësime të bëra në zyrën e marrë me qira dhe blerje të pajisjeve të ndryshme për zyrën si dhe aktivi në ndërtim e sipër. Kostot e kapitalizuara për aktivin në ndërtim e sipër përbëhen nga kostot e shërbimeve për marrjen e të drejtës së përdorimit dhe shpronësimin e tokës së projektit, shërbimet ligjore, pagat e punonjësve dhe kostot e tjera të nevojshme gjatë fazës së zhvillimit dhe që lidhen drejtpërdrejt me projektimin dhe zbatimin e ndërtimit të gazsjellësit.

Me 31 Dhjetor 2018 dhe 2017, Shoqëria nuk ka asnjë aktiv afatgjatë të lënë si kolateral.

8. TVSH e arkëtueshme

TVSH e arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 është 15,641,896 mijë lekë (2017: 11,485,287 mijë lekë) përfaqëson shumën e TVSH-së që do të bartet për vitet 2016 deri 2018. Gjatë vitit 2016, Autoritetet Tatimore miratuan TVSH-në e arkëtueshme të kërkuar për rimbursim të krijuar nga aktivitetet nga periudha midis 2015 dhe gjysmës së parë të vitit 2016 shuma të rimbursuara fizikisht gjatë vitit 2017. Shoqëria ka filluar procedurat e rimbursimit për të kërkuar TVSH-në e arkëtueshme për periudhën e mbetur në baza tremujore. Një total prej 3,030,161 mijë lekësh u rimbursuan gjatë vitit 2018 dhe më pas, një total prej 3,160,518 mijë lekësh u rimbursuan gjatë vitit 2019.

9. Aktive të tjera

Shuma e aktiveve të tjera më 31 dhjetor 2018 prej 607,181 mijë lekë (2017: 5,574,678 mijë lekë) përfaqëson një garanci depozite për zyrën me qira si dhe parapagimet e bëra nga Shoqëria ndaj palëve të treta për shërbimet që do të merren pas datës së raportimit.

10. Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare

	Në 31 Dhjetor 2018	Në 31 Dhjetor 2017
Para në dorë	45	349
	45	349
Para në bankë		
Llogari rrjedhëse në EUR	-	289,294
Llogari rrjedhëse në LEK	85,962	161,372
	85,962	450,666
Totali	86,007	451,015

Mjete monetare dhe ekuivalente të mjeteve monetare të shpalesura më lart dhe në pasqyrën e fluksit të parave në dorë dhe llogari rrjedhëse. Cilësia e aftësisë së kreditimit të institucioneve financiare në të cilat mbahen llogaritë rrjedhëse bazuar në vlerësimet e Standard and Poor mund të përmbledhet si më poshtë në 31 Dhjetor 2018 dhe 2017.

	2018	2017
Senior afatgjatë i preferuar (I pasiguar)	BBB	BBB-
Afat shkurtër	A-2	A-3
Outlook LT Senior i preferuar (I pasiguar)	Negative	E qëndrueshme

11. Tatim fitimi

Në përputhje me legjislacionin shqiptar tatimor, norma standarte e tatim fitimit për vitin 2018 është 15% (2017: 15%). Sidoqoftë, bazuar në paragrafin 24.6 të Marrëveshjes së Qeverisë së Vendi Pritës ("MQP") midis TAP AG dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë në Shqipëri, niveli i tatim fitimit I aplikueshëm për TAP është 10% (d.m.th. norma e tatim fitimit që nga 28 janari 2013, data efektive e hyrjes në fuqi të MQP).

Deklarimet tatimore paraqiten çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten provizore deri kur organet tatimore të shqyrtojnë regjistrimet kontabel dhe deklarimet tatimore të tatimpaguesit dhe të lëshojnë vlerësim përfundimtar për to. Zbatimi i legjislacionit tatimor shqiptar dhe i udhëzimeve të tyre perkatëse janë objekt i interpretimit nga autoritetet tatimore shqiptare.

Shoqëria ka rezultuar me fitim për qëllime kontabël dhe qëllime tatimore duke marrë parasysh detyrimin e njohur për tatim fitimit në vlerën 108,192 mijë lekë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 (2017: 17,896 mijë lekë).

Për vitin 2018 dhe 2017 Shoqëria ka raportuar të ardhura kontabël dhe tatimore.

Nuk ka humbje të mbartura tatimore.

(a) Komponentë të shpenzimit të tatim fitimit

Shpenzimi i tatim fitimit i njohur në fitim apo humbje të e periudhës përfshin si vijon:

Në mijë LEK	2018	2017
Detyrimin aktual të tatim fitimit	108,192	17,896
Detyrimin e shtyrë të tatim fitimit	-	-
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	108,192	17,896

(b) Rakordimi midis shpenzimit tatimor dhe fitimit ose humbjes duke zbatuar normën tatimore në fuqi

Norma e tatim fitimit i zbatueshem për Shoqërinë në vitin 2018 është 10% (2017: 10%). Një rakordim midis shpenzimit kontabël dhe atij tatimor për tatim fitimin jepet më poshtë.

	2018	2017
Fitimi vjetor kontabël para tatim fitimit	1,063,035	170,524
Detyrimi tatimor / (teprica kreditore) në normën e fiksuar (2018: 10%; 2017: 10%)	106,304	17,052
Efekt i tatimor i shpenzimeve të pazbritshme	-	678
Efekt i tatimor i shpenzimeve jo të tatueshme (diferenca të perkohshme)	1,888	112
Shpenzimi i tatim fitimit për vitin	108,192	17,896

(c) Detyrimi për tatim fitimin

	Në 31 Dhjetor 2018	Në 31 Dhjetor 2017
Në 1 Janar	4,040	14,262
Pampagimet e tatim fitimit	(6,025)	(13,856)
Rimbursimi i tatim fitimit përmes detyrimeve të tjera tatimore	(15,771)	(14,262)
Detyrimi i tatim fitimit i pagueshëm	108,192	17,896
	90,436	4,040
Efekt i përkthimit në monedhën e paraqitjes	(6,318)	(1,005)
Totali	84,118	3,035





(d) Pozicionet e pasigurta të tatim fitimit

Detyrimet aktuale të tatim fitimit në lidhje me pozicionet e pasigurta në lidhje me zbritshmërinë e shpenzimeve për qëllime tatimore. Drejtimi vlerëson që të tilla ekspozime ka më shumë të ngjarë se jo të kërkojnë shlyerje nëse kundërshtohen nga autoritetet tatimore. Balanca e raportuar në 31 Dhjetor 2018 pritet të shfrytëzohet ose konfirmohet plotësisht kur të parashkruhen e drejta për kontroll nga autoritetet tatimore në lidhje me deklaratat përkatëse tatimore.

12. Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera

	Në 31 Dhjetor 2018	Në 31 Dhjetor 2017
Kostot të përlogaritura të kapitalizuara	4,007,211	15,478,854
Të pagueshme ndaj furnitorëve	35,021	37,651
Totali	4,042,232	15,516,505

Të pagueshme tregtare më 31 Dhjetor 2018 përbëhen kryesisht nga punime ndërtimi të kryera nga kontraktorët kryesorë të Shoqërisë për ndërtimin e seksionit detar të tubacionit të gazsjellësit si dhe të stacioneve të kompresorëve dhe të matjes.

13. Provigjionet

	IPMT	LATS	ESMS	SEI	Cështje gjyqësore	Totali
Vlera kontabël në 1 Janar 2017	1,414,005	510,243	54,643	2,960,984	6,247	4,946,122
Shtesa në provigjione të njohura në fitim ose humbje	-	-	-	-	-	-
Shtesa në provigjione të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar	(899,108)	(36,376)	114,309	(988,465)	513	(1,809,127)
Diferencë përkthimi	(72,041)	(35,388)	(7,644)	(180,016)	(456)	(295,545)
Vlera kontabël në 31 Dhjetor 2018	442,856	438,479	161,308	1,792,503	6,304	2,841,450

Me 31 Dhjetor 2018, shpenzimet e përlogaritura janë në vlerën prej 2,841,450 mijë lekë (2017: 4,946,122) dhe përfaqësojnë shpenzime për veprimtari të planifikuara dhe të miratuara nga Drejtimi i Shoqërisë për Investimet në Komunitet - IPMT, Investimet në Projekte me Ndikim Social dhe Mjedisor - SEI, Asistencën në Tranzicionin për Rikthimin e gjendjes së mjeteve të jetesës të komunitetit - LATS, dhe projektet në Sistemin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social - ESMS.



14. Detyrime të tjera	Në 31 Dhjetor 2018	Në 31 Dhjetor 2017
Garanci e vënë nga furnizuesit për kryerjen e kontratës	1,552,341	658,037
Detyrime për tatime të tjera	9,522	11,190
Pagesat e llogaritura për lejet e punonjësve	6,332	5,489
Bonus të pagueshme punonjësve	7,954	4,657
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	2,364	2,304
Tatim mbi të ardhurat personale nga punësimi	-	-
Tatimi i mbajtur në burim	131	147
TOTALI	1,578,644	681,824

Detyrimet për tatime të tjera janë detyrime të llogaritura për tatim fitimit të pagueshëm që nga viti 2012 e më pas për të cilat periudha dispozitat finale të Marrëveshjes së Cmimit në Avancë (MCA)-së nuk janë zbatuar për qëllime të tatimit fitimit. Këto detyrime të përlogaritura tatimore do të mbyllet kundrejt detyrimit final të tatimit fitimit që do njihet dhe regjistrohet në amendimit të deklaratës së tatimit fitimit dhe pasi të jenë paguar detyrimet përkatëse (pritet në 2020).

15. Të ardhura të atribuara	Në 31 Dhjetor 2018	Në 31 Dhjetor 2017
Shpenzimet operative të rifaturuara	174,109	164,098
Marzh fitimi në normën 12%	20,893	19,692
Totali	195,002	183,790

Bazuar në APA, të ardhurat do t'i atribuohen Shoqërisë mbi bazën e kostove operacionale plus një marzh fitimi prej 12% deri sa gazsjellësi të ndërtohet dhe të hyjë në shfrytëzim. Shpërblimi (e ardhura) përcaktohet bazuar në shpenzimet lokale operacionale (OPEX, të njohura sipas SNRF) të kryera nga Shoqëria gjatë një viti, plus një marzh fitimi prej 12%. Për vitin 2018, marzhi i fitimit i zbatuar në llogaritjen e të ardhurave të atribuara Shoqërisë është në normën 12% sipas dispozitave të APA. Sipas dispozitave përfundimtare të APA-së, marzhi i fitimit në normën 12% mbi shpenzimet operacionale të Shoqërisë është i zbatueshëm për vitet që nga viti 2012 (viti i parë i aplikimit të APA).

Shpenzimet operacionale të rifaturuara janë si më poshtë:

	Në 31 Dhjetor 2018	Në 31 Dhjetor 2017
Shpenzimet e personelit	77,260	92,854
Shpenzimet administrative	89,832	75,168
Shpenzimet e amortizimit	7,017	7,267
Shpenzimet totale operacionale	174,109	175,289
Shpenzimet apo detyrimet për tatimet e tjera	-	(11,190)
Shpenzimet totale operacionale të rifaturuara	174,109	164,099

Shpenzimet që kanë të bëjnë me detyrimet për tatime të tjera zbriten për qëllim të llogaritjes së bazës së kostove totale operacionale të rifaturuara pasi ato lidhen me detyrimet e përlogaritura shtesë për tatim fitimit për vitet që nga viti 2012 për të cilat dispozitat përfundimtare të APA-së nuk janë zbatuar ende për qëllim të tatimit fitimit si shpjeguar në Shënime 11 dhe 20.





16. Shpenzimet e personelit	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Pagat e personelit	68,035	84,804
Shpenzimet e sigurimit	628	697
Shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore	3,909	3,592
Shpenzime të tjera të personelit	4,688	3,761
Totali	77,260	92,854

17. Shpenzimet administrative	31 Dhjetor	31 Dhjetor 2017
Shpenzimet për publikime njoftimesh Projekte IT	40,456	32,841
	15,913	338
Shërbime fiskale dhe kontabël	9,005	6,052
Shërbime konsulence	6,007	8,143
Shërbime të tjera	5,361	1,714
Shpenzimet e qirasë për zyra dhe parkimi	4,215	4,672
Sponsorizime	2,725	4,191
Shpenzime udhëtimi	2,544	2,171
Shpenzime të mirëmbajtjes	1,735	1,500
Shpenzime telekomunikimi	744	784
Shpenzime të tjera administrative	739	972
Tarifat e anëtarësisë	142	93
Tatime të tjera	126	11,361
Shpenzime sigurimi	104	288
Shërbime postare	16	15
Taksa vendore		33
Totali	89,832	75,168

"Shërbimet e konsulence" prej 6,007 mijë lekësh në 31 dhjetor 2018 (2017: 8,143 mijë lekë) konsistojnë në shërbime konsulence teknike dhe të ngjashme, të cilat nuk lidhen drejtpërdrejt me projektimin dhe ndërtimin e gazsjellësit dhe kështu nuk janë kapitalizuar.

"Shërbime të tjera" në vlerën prej 5,361 lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 1,714 mijë lekë) përbëhen nga shpenzimet e zakonshme të shërbimeve, tarifat e aplikimit dhe të ndërtimit, shërbimet e rekrutimit, shpenzimet përfaqësimi të projektit dhe shpenzime të tjera.

"Shpenzimet e telekomunikimit" në vlerën prej 744 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 784 mijë lekë) përbëhen nga shpenzime telefonike dhe interneti.

"Shpenzime të tjera administrative" në vlerën 739 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 972 mijë lekë) përbëhen nga shpenzimet kancelarike, shërbimet e përkthimit, shpenzimet e noterit dhe shpenzime të tjera.

27
 [Signature]

Trans Adriatic Pipeline AG - Degë e Shoqërisë së Huaj në Shqipëri
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare – 31 Dhjetor 2018

(Të gjitha shumat në mijë Lekë, përveç nëse përkohet ndryshe)



“Tatime të tjera” në vlerën 0 mijë lekë më 31 dhjetor 2018(2017: 11,361 mijë lekë) përfshijnë shpenzime për detyrime të tatim fitimit të llogaritura në lidhje me të ardhurat e alokuara sipas dispozitave përfundimtare të APA-së të nënshkruara në vitin 2018 për një shumë prej 11.190 lekë, me shumën e mbetur që përbëhet nga kamatvonesat tatimore të llogaritura.

18. Fitimi nga kursi i këmbimit valutor, neto	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Fitimi nga këmbimit valutor	1,045,995	469,280
Humbje nga këmbimi valuator	(2,518)	(319,189)
Fitime nga këmbimi i huaj valutor, neto	1,043,477	150,091

Fitimi neto nga këmbimi valutor, për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018 në shumën 1,043,477 mijë lekë (2017: 150,091 mijë lekë) rrjedh kryesisht nga rivlerësimi i balancave të transaksioneve të mbajtura në monedhë të huaj (LEK) dhe të ripërkthyer në monedhën funksionale të Shoqërisë (EUR).

19. Angazhimet dhe Kontingjencat

Gjatë veprimtarisë normale, Shoqëria mund të përfshihet në procedura ligjore, pretendime dhe kontestime me palë të treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e mundshme në të ardhmen nuk do të ketë një efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë, rezultatet e veprimtarisë apo mbi flukset monetare të Shoqërisë.

Me 31 Dhjetor 2018 dhe 2017, Shoqëria nuk ka ndonjë zotim kontraktual kapital të papaguar.

Angazhimi për qiranë


Shoqëria është e angazhuar për pagesat e mëposhme të ardhshme për qiranë e saj të zyrës.

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Nga 1 në 5 vjet	89,993	28,009
Total	89,993	28,009

20. Transaksione dhe balanca/gjendje me palët e lidhura

Palët konsiderohet të jenë të lidhura nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër me qëllim të marrjes së vendimeve financiare ose operacionale, ose kur palët janë nën kontroll të përbashkët me Degën.

Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike, nëse, drejtpërdrejt ose indirekt, përmes një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollohet nga pala, kontrollohet ose nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, pala ka interes në njësinë ekonomike që i jep asaj ndikim të rëndësishëm mbi njësinë ekonomike, pala ka një kontroll të përbashkët mbi njësinë, pala është një bashkëpunëtorë ose pala është një anëtare e personelit kryesor menaxhues të njësisë ekonomike ose prindit të saj.



Balanca e mbetur neto e atribuuar Zyrës Qendrore ndahet gjithashtu si në vijim:

Të pagueshme ndaj Zyrës Qendrore më 31 dhjetor 2018 lidhen me fondet e dhëna nga Zyra Qendrore për t'u përdorur në veprimtarinë operative të Shoqërisë.

Të arkëtueshme nga Zyra Qendrore konsistojnë në shpenzimet vjetore operationale të ngarkuara nga Shoqëria drejt Zyres Qendrore me një marzh fitimi prej 12% për vitet 2012-2017 në bazë të Marrëveshjes shumëpalëshe të Cmimeve të Avance ("APA") të nënshkruar nga autoritetet kompetente të Zvicrës, Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë gjatë vitit 2018. Për vitet që nga 2012, për të cilat dispozitatë perfundimtare të APA-së nuk janë zbatuar ende, janë njohur si të arkëtueshme përkatëse nga Zyra Qendrore.

Shoqëria nuk ka kryer transaksione dhe balanca të tjera me palët e lidhura.

Balancat e transaksionit	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Të pagueshme ndaj Zyres Qendrore		
Shpenzime të alokuara	(136,846,562)	(99,822,251)

Volumi i transaksioneve

Të arkëtueshme nga Zyra Qendrore		
Te ardhurat e alokuara	946,673	816,561

Kompensimi kryesor i Drejtimit. Drejtimi kryesor i Shoqërisë përfshin vetëm përfaqësuesin ligjor prandaj për arsye konfidencialiteti kompensimet nuk shpalosen.

21. Ngjarjet pas periudhës së raportimit

COVID-19

Në fund të vitit 2019 u shfaqën fillimisht lajmet për COVID-19 (Coronavirus), ku u raportua një numër i kufizuar rastesh të prekur nga një virus i panjohur. Në muajt e parë të vitit 2020, virusi u përhap globalisht, një pandemi filloi në disa vende. Pandemia vazhdon të bëjë që qeveritë të marrin masa gjithnjë e më kufizuese për të mbrojtur popullsinë dhe për të zvogëluar përhapjen e virusit. Masat e marra do të ndikojnë në tërë mjedisin ekonomik dhe shoqëror në një shkallë globale të pa precedent.

Aktualisht përfundimi i projektit pritet brenda të tremujorit e katërt të 2020 duke përjashtuar ndikimin e COVID-19.

Në datën e këtij dokumenti, Drejtimi i Shoqërisë vazhdon të vlerësojë situatën e COVID-19 dhe ndikimin e saj në veprimtarinë e Shoqërisë. Ndikimet e tilla do të duhet të monitorohen dhe rishqyrtohen në të ardhmen e afërt dhe të shkurtër, duke pasur parasysh natyrën e pa precedent dhe në ndryshim të shpejtë të situatës aktuale.

Situata nën COVID-19 nuk ka asnjë ndikim në pasqyrën financiare të SNRF 2018.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime ose shpalosje shtesë në këto pasqyra financiare.





22. Politikat kontabël para 1 janarit 2018

Instrumentet financiare

Instrumente financiare jo-derivativë

Instrumentet financiare jo-derivativë të Shoqërisë përfshijnë tregtinë dhe të arkëtueshme të tjera, mjete monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare, detyrimet e tjera, dhe të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Shoqëria fillimisht njihet të arkëtueshmet tregtare në datën kur ato janë origjinuar. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit kur njësia ekonomike bëhet palë në provizionet kontraktuale të instrumentit.

Shoqëria nuk njihet një aktiv financiar kur skadojnë të drejtat e kontratës për flukset monetare nga aktivi, ose transferon të drejtat për të marrë flukset monetare kontraktuale në një transaksion në të cilin në të vërtetë janë transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar, ose as nuk transferon dhe as ruan në mënyrë thelbësore rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin mbi aktivin e transferuar. Cdo interes për aktivet e tilla financiare që nuk njihen, që janë krijuar ose mbajtur nga Shoqëria, njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë. Shoqëria nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale përfundojnë, anulohen ose skadojnë.

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen, dhe shumat neto paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Shoqëria aktualisht ka një të drejtë të zbatueshme me ligj për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë aktivin dhe shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht të matura me vlerën e drejtë plus çdo kosto të transaksionit që mund t'i atribuohet drejtpërdrejt. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kontabiliteti i kostove të huamarrjes

Shoqëria kapitalizon kostot e huamarrjes që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aktivi kualifikues si pjesë e koston së këtij aktivi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të bartura me koston e amortizuar

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura ose shpenzime kur ndodhin si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarjeve të humbjes") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit financiar dhe që kanë ndikim në sasinë kohës së fluksit të parashikuar të ardhshëm të parasë së aktivit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.





22. Politikat kontabël para 1 janarit 2018 (vazhdim)

Nëse Shoqëria përcakton se nuk ekziston asnjë dëshmi objektive që zhvlerësimi është bërë për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ai përfshihet në një grup të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit, dhe kolektivisht i vlerëson ato për zhvlerësim. Faktorët kryesorë që Shoqëria i konsideron në përcaktimin nëse një aktiv financiar është zhvlerësuar janë statusi i tij i vonuar dhe realizueshmëria e kolateralit lidhur me të, nëse ka. Kriteret kryesorë të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka dëshmi objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi:

- Pala tjetër përjeton një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informacioni i saj financiar që merr Shoqëria;
- Pala tjetër konsideron falimentimin ose një riorganizim financiar;
- ka ndryshim negativ në statusin e pagesës së palës tjetër si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë në palën tjetër; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, zvogëlohet ndjeshëm si rezultat i përkeqësimit të kushteve të tregut.

Nëse kushtet e një aktivi financiar të dëmtuar të mbajtur me koston e amortizuar rinegociohen ose modifikohen ndryshe për shkak të vështirësive financiare të palës, zhvlerësimi matet duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv para modifikimit të kushteve. Pasuria e rinegociuar më pas reregjistrohet dhe një aktiv i ri njihet me vlerën e tij të drejtë vetëm nëse rreziqet dhe shpërblimet e aktivit ndryshojnë ndjeshëm. Kjo zakonisht dëshmohet nga një ndryshim thelbësor midis vlerave aktuale të flukseve monetare fillestare dhe flukseve të reja të pritshme të parave.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen gjithmonë përmes një llogarie lejimi për të shënuar vlerën kontabël të aktivit në vlerën aktuale të fluksit të parave të pritura (të cilat përfshijnë humbjet e kreditit në të ardhmen që nuk janë bërë) të zbritura me normën fillestare efektive të interesit të aktivit. Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve monetare të parashikuara në të ardhmen të një aktivi financiar të kolateralizuar pasqyron fluksin e parave që mund të vijë nga bllokimi i shpenzimeve më të ulëta për marrjen dhe shitjen e kolateralit, pavarësisht nëse foreclosure është i mundshëm.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes së zhvlerësimit zvogëlohet dhe ulja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit (siç është një përmirësim në vlerësimin e kreditit të debitorit), humbja e zhvlerësimit e njohur më parë kthehet nga rregullimi i llogarisë së lejimit përmes fitimit ose humbjes për vitin.

Aktivet e pa arkëtueshme reregjistrohen kundrejt provigjionit të humbjes nga zhvlerësimi pasi të gjitha procedurat e nevojshme për rikuperimin e aktivit kanë përfunduar dhe shuma e humbjes është përcaktuar. Rikuperimet pasuese të shumave të shkruara më parë i kreditohen llogarisë së humbjes së zhvlerësimit brenda fitimit ose humbjes për vitin.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare përfshijnë bilancet e parave dhe depozitat me maturitet fillestar prej tre muajsh ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

31
Hunj

22. Politikat kontabël para 1 janarit 2018 (vazhdim)

Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshme tregtare dhe të tjera janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë kuotuar në një treg aktiv. Aktivet e tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto të transaksionit që mund t'i atribuohen drejtpërdrejt. Pas njohjes fillestare, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të vlerës së marrë ose të arkëtueshme, dhe përfaqësojnë shumat e arkëtueshme për mallrat e furnizuar, deklaruar neto nga zbritjet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e situar.

Shoqëria njih të ardhurat kur shumat e të ardhurave mund të maten me besueshmëri; kur është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin tek njësi ekonomike; dhe kur janë përmbushur kritere specifike për secilin nga aktivitetet e Shoqërisë, siç përshkruhet më poshtë. Kur vlera e drejtë e mallrave të marra në një transaksion shkëmbimi nuk mund të matet me besueshmëri, të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të hequra.

Shitjet e mallrave. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në pikën e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë së mallrave, normalisht kur mallrat dërgohen. Nëse Shoqëria pranon të transportojë mallra në një vend të caktuar, të ardhurat njihen kur mallrat i kalohen klientit në pikën e destinacionit.

Shitjet e shërbimeve. Shitjet e shërbimeve njihen në periudhën e llogaritjes në të cilën kryhen shërbimet, duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit aktual të ofruar si pjesë e totalit të shërbimeve që do të ofrohen.

Të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e proporcionit në kohë duke përdorur metodën e interesit efektiv.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER DENISA ÇELA

DATE 27/05/2020
NR REP 1294



V2020453750074229005

VËRTETIM PËRKTHIMI

Soi, më datë 27/05/2020, para meje Notere DENISA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NJESIA BASHKIAKE NR. 10, RR, RESHIT ÇOLLAKU, GODINA NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA NR.7, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:
Person Fizik Anila Binaj, regjistruar në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L11703001M, me seli në Tiranë, me adresë Rruga "Avdyl Matoshi", Nr.63, Godinë Private, Kati 3, përfaqësuar nga Anila Binaj, atësin Lulëzim, amësin Liljana, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan, Elbasan dhe banuese në TIRANË, me adresë Njesia bashkiake nr. 8 Rruga Cijon Buzuku Ap 6 ,, lindur më 04/07/1985, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033795024 dhe nr. personal I55704067B.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, le cili/a më deklaroi se përktheu me përpikëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur "Pasqyrat Financiare ne dhe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 te Trans Adriatic Pipeline AG", nga gjuha Angleze në gjuhën Shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE
DENISA ÇELA